

## REGJISTRIMI I POPULLSISË SË SHQIPËRISË MBI PËRKATËSINË FETARE

Historitë gjithmonë përshkruajnë të shkuarën për të mësuar prej ngjarjeve dhe ndodhive të popujve të ndryshëm. Sa më mirë të njihen veprimtaritë, hollësitë, detajet e gjithçka kryen një popull, historianët në shkrimin e historisë do të jenë më objektivë, më të saktë. Na rezulton me mangësi të theksuar një studim i mirëfilltë i statistikave të popullsisë mbi përkatësinë fetare në gjuhën shqipe. Për këtë, ndërmorëm një hap, për të dhënë kontributin tonë drejt plotësimit të historisë së popullit tonë në disa detaje dhe objektivisht, duke shpresuar që kontributi të jetë i vlefshëm për gjithkënd nga lexuesit.

### Hyrje

Gjithmonë lexojmë, dëgjojmë dhe na është ngulitur tashmë në mendjen tonë që shqiptarët janë popull pothuajse 100% besimtarë, ku shifrat e publikuara historikisht janë: 70% muslimanë, në të cilën përfshihen shumica sunitë, bektashinjtë dhe sekte të tjera islame, 20% ortodoksë dhe 10% katolikë. Në 2 dekadat e fundit janë shtuar dhe sekte tjera të krishtera, si: protestantë, jehovaj etj.

Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane në trojet e banuara nga shqiptarët, regjistrimet e bëra na jepnin raportin se shqiptarët ishin pothuajse 100% besimtarë (të besimeve të ndryshme), me një raport të tillë (70-20-10 për qind). Me të drejtë thonë se pushteti i privilegjonte muslimanët 'sipas opinionit shqiptar', por këto shifra ishin pa ndonjë luhatje të madhe pothuajse gjatë gjithë periudhës kohore, deri në 1967 kur janë bërë regjistrimet e popullsisë duke përfshirë dhe përkatësinë fetare. Si ka mundësi që ky raport nuk ndryshoi gjatë viteve 1912-1939, gjithashtu i pandryshuar ishte sërish dhe në periudhën 1939-1945?! Edhe më keq për fetarët ishte periudha e komunizmit, por statistikave vazhdojnë me të njëjtin raport, sa i përket ndarjes së përkatësisë

fetare (70%, 20%, 10%).

Ajo që të duket më e çuditshme është se, edhe pse gjatë 45 viteve komuniste të historisë së Shqipërisë, u rritën dhe u edukuan breza të tërë që nuk besonin në Zot, duke filluar që tek ata që lindën në fillim të viteve 1937-1940 deri tek të lindurit e fillimviteve '80, pavarësisht kësaj, statistikat tregojnë pothuajse të njëjtën gjë, madje edhe mbas 20 viteve të rënies së komunizmit, në Censusin e vitit 2011, në të cilin u bë regjistrimi mbi baza etnike dhe fetare mbas shumë vitesh, ku ateistët nuk janë më shumë se 2.5% e popullsisë!

Gjithë këto të dhëna të bëjnë përshtypje dhe secili mund të ketë gjykimin e tij dhe rezerva mbi saktësinë e këtyre të dhënave, por çfarë ka ndodhur me regjistrimet e popullsisë në Shqipëri realisht? Sa fetarë kanë qenë shqiptarët duke u bazuar në këto të dhëna!? Sa të vërteta janë këto statistika?

### **Çfarë trashëguam nga Perandoria Osmane?**

Statistikat Osmane në trevat në të cilat banonin shqiptarët, janë vërtet, të shumta, por si thonë dhe studiuesit e demografisë: *Kur flitet për strukturimin e popullsisë së trevave shqiptare, mbështetur në statistikat osmane, gjithmonë duhet të kemi parasysh komponentët e hapësirës së trevave shqiptare bashkë me popullsinë që banonte në të. Për këtë është e domosdoshme që këta dy tregues duhet të jepen së bashku. Në asnjë mënyrë nuk mund të merret treguesi i shkëputur nga hapësira referuese.*<sup>69</sup>

Regjistrimet e para të popullsisë në trojet shqiptare datohen shumë herët, që në shekullin XV, saktësisht në vitin 1431-1432, të bëra nga administrata e Perandorisë Osmane në "Regjistrin e Sanxhakut Shqiptar"<sup>70</sup>. Normalisht, regjistrimet vazhduan përgjatë shekujve derisa shqiptarët ishin nën Perandori, të dhënat kryesore që merreshin në regjistrimin e bërë, ishin nga më të ndryshme, si p.sh.: emri, mbiemri (epiteti shpeshherë), mosha, përkatësia fetare, përkatësia etnik, seksi, pasuria që kishte (shtëpi, kafshë, pemëtari etj.). Këto të dhëna sillnin numrin e popullsisë dhe politikën e Perandorisë ndaj secilit vend,

69 Bërxoli, Arqile: *Minoritetet në Shqipëri*; Tiranë, 2005, fq. 67.

70 Grup autorësh: *Historia e popullit shqiptar*; Vëllimi I, Akademia e Shkencave, TOENA, Tiranë, 2002, fq. 378.

pasi thelbi i statistikave të Perandorisë ishte ngritja e sistemit të Timarit-politikave fiskale- thënë në gjuhën e sotme.

Disa nga regjistrimet e përgjithshme të bëra nga Perandoria Osmane gjatë shek. XIX ishin në vitet<sup>71</sup> 1831, 1844, 1859-60, 1885, 1906-1907, por të dhëna të hollësishme të popullsisë kemi pothuajse përgjatë gjithë kohës së sundimit Osman, pra nga 1431 deri në rënien e Perandorisë. Mbi këto të dhëna përcaktoheshin taksat dhe llojet e tyre për shtetasit osmanë, përgatitej ushtria, gjithashtu shpërndaheshin investimet në sektorë të ndryshëm etj. Të dhëna mbi popullsinë kemi dhe në vitet 1820, 1840, 1850, 1856, 1860, 1867, 1873/4, 1881/1882, 1893-1898, 1910, 1912, të dhëna që mund të sigurohen nga regjistrat e Perandorisë Osmane. Normalisht, aty përfshiheshin 4 vilajete në të cilat jetonin shqiptarët, vilajeti i Kosovës, i cili ishte dhe më i madhi për nga sipërfaqja dhe popullsia, i Janinës, i Manastirit dhe i Shkodrës, që ishte më i vogli për nga sipërfaqja dhe popullsia.

Sipërfaqja tokësore, e cila më së shumti banohej nga shqiptarët, varionte nga 65.000 km<sup>2</sup> që japin disa të dhëna, deri në 92.000 km<sup>2</sup> që japin disa të dhëna tjera. Por të dhënat më të sakta na thonë që sipërfaqja e trojeve ku banonin shqiptarët, ishte rreth 75.000-80.000 km<sup>2</sup>, pra duke përfshirë në tërësi 4 vilajetet të banuara me shumicë të theksuar dhe të dalluara qartë nga shqiptarët.<sup>72</sup>

Në të gjithë këto vilajete, shumica e popullsisë ishin shqiptarë, rreth 65%-70% në Vilajetin e Manastirit, që kishte numrin më të vogël të shqiptarëve, deri në mbi 90% të popullsisë në vilajetin e Shkodrës. Sa i përket përkatësisë fetare, shumica e popullsisë i përkiste besimit Islam me rreth 65%-72%, pjesa tjetër ishin të krishterë, më shumë ortodoksë dhe një pakicë e katolikëve në vilajtin e Shkodrës.<sup>73</sup> Në lidhje me këto të dhëna, burimet që japin këto shifra, janë të shumta, nuk janë vetëm studiues muslimanë ata që përmendin këto shifra, por dhe studiues të krishterë e në përgjithësi perëndimorët.

Sipas Sami Frashërit, popullsia e gjithë Shqipërisë (nënkupton 4 vilajetet shqiptare - E. Sh.) në vitin 1889-1898 shkon afërsisht deri në 2.5 milionë frymë, nga të cilët 2 milionë janë shqiptarë

71 [www.gazetastar.com/index.php?p=hg&hid=4514](http://www.gazetastar.com/index.php?p=hg&hid=4514)

72 Për më gjerësisht shih Sami Frashërin, Kemal Karpat, *Historia e popullit shqiptar, I-II*, TOENA, 2002 etj. të cituar më poshtë gjerësisht.

73 Karpat, Kemal H.; *Ottoman Population 1830-1914*; Michigan USA, 1984.

dhe 500.000 janë vllleh, bullgarë, grekë dhe evgjitë.<sup>74</sup> N d ë r s a studiuesi Kemal Karpat, në një botim të tij na thotë që në vitin 1831 shqiptarët në Ballkan nën Perandorinë Osmane numëronin 1.596.000 banorë, prej të cilëve 1.066.000 muslimanë dhe 530.000 të krishterë;<sup>75</sup> duhet të theksojmë që një pjesë e tyre mund të vetëdeklaroheshin si ortodoksë-grekë, dhe kjo është botërisht e njohur. Gjatë viteve në vazhdim, mbas vitit 1831, shohim një luhatje të popullsisë, fillimisht një rritje të numrit të popullsisë, e më pas zvogëlim të theksuar. Ky zvogëlim i popullsisë shqiptare ka të bëjë me një pjesë të trojeve shqiptare që filluan të ndaheshin nga vilajetet osmane, por dhe shpërnguljet e mëdha që nisën të bënin shqiptarët-muslimanë duke i larguar vatrave të mëdha të luftës, që u përhapën gjithandej, për të gjetur qetësi në kryeqendrën e Perandorisë, pra në Stamboll, i cili, në fund të shek. XIX, kishte rreth 10.000 shqiptarë<sup>76</sup>, apo dhe qytete tjera të Perandorisë, duke përfshirë këtu dhe vendet arabe, në veçanti Sirinë, ku janë shpërngulur shumë shqiptarë muslimanë. Por ndikues në pakësimin e popullsisë shqiptare në mënyrë të veçantë ishte dhe fakti që ortodoksët shqiptarë në trojet në të cilat ishin vendosur gjatë luftërave që u zhvilluan nga fqinjët e Shqipërisë për t'i pushtuar këto territore, vetëdeklaroheshin në kombësi të tyre si ortodoksë-grekë apo ortodoksë-sllavë, për t'u shpëtuar persekutimeve.

Statistikat mbi numrin e popullsisë të vilajeteve shqiptare për vitet e fundit të shekullit XIX dhe fillimin e shek. XX janë si më poshtë:<sup>1</sup>

Vilajeti	1893	1894	1895	1896	1897	1899	1906
Kosova	721.087	721.342	721.342	721.342	755.639	954.634	671.635
Manastiri	664.399	664.399	664.399	664.399	712.217	1061.522	824.282
Shkodra	87.375	87.372	87.372	87.372	87.529	337.584	89.848
Janina	51.6477	516.477	516.467	511.913	516.681	517.274	516.766
TOTAL	1.989.338	1.989.590	1.989.580	1.985.026	2.072.066	2.871.014	2.102.531

74 Frashëri, Sami: *Vitet shqiptare në Kamusul Al-lam*; LOGOS-A, Shkup, 2004, fq. 25.

75 Karpat, Kemal H.: *Ottoman Population 1830-1914*; Michigan USA, 1984, fq. 20, 46

76 Po aty fq. 104-105.

Ndërsa studiuesja bashkëkohore turke Nuray Bozborra, në studimin e saj “Nacionalizmi shqiptar”, periudha kohore 1830-1912, thotë se: *Përkundrejt 2/3 të popullsisë shqiptare që janë muslimane, 1/3 është e krishtere. Shqiptarë të krishterë janë kryesisht fise katolike që jetonin në Veri-Perëndim të Shqipërisë, ndërsa ortodokse është popullsia shqiptare që jeton në afërsi të kufirit shqiptaro-grek.*<sup>77</sup>

Historia zyrtare e periudhës komuniste na thotë se: *Sipas organizimit administrativo-territorial të Perandorisë Osmane, në fillim të shek. XX, trojet shqiptare ishin ndarë në katër njësi administrative-territoriale, të quajtura vilajete, më tej në 15 sanxhaqe dhe në 80 kaza, në të cilat jetonte një popullsi prej 1.7 milion banorë në vitin 1850.*<sup>78</sup>

Sipas statistikës zyrtare të Perandorisë Osmane të nxjerrë nga studiuesit shqiptarë të Akademisë së Shkencave, në vitin 1912<sup>79</sup> popullsia në katër vilajetet e banuara nga shqiptarët ishte afërsisht kjo:

VILAJETI	Popullsia totale	Popullsia shqiptare	Popullsia shqiptare e ndarë në përqindje
Kosovë	909.700	558.900	61.4 %
Manastir	694.800	375.900	54.1%
Janinë	559.700	330.800	59.1%
Shkodër	190.000	186.500	98.2%
GJITHSEJ	2.354.200	1.452.100	61.7%

Sipas tabelës së paraqitur, normalisht shumica ishin shqiptarë, të tjerët sllavë, grekë, bullgarë, malazezë, turq, vlllehë etj.

E rëndësishme për këtë periudhë është se ndryshe nga sa shprehen disa ‘pseudo-studiues’ se regjistrimi i bërë nga Perandoria Osmane lë shumë për të dëshiruar dhe ka mangësi të shumta, për mendimin tonë, në regjistrimin e bërë nga administrata osmane ka pasur shumë detaje, të dhëna të

77 Bozborra, Nuray: *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*; DITURIA, Tiranë, 2002, fq.65.

78 Grup autorësh: *Historia e Shqipërisë II*; Tiranë, 1984, cituar nga Arqile Bërxoli: *Minoritetet në Shqipëri*; Tiranë, 2005, fq.60.

79 Grup autorësh: *Historia e popullit shqiptar, Vllimi II*; Akademia e Shkencave, TOENA, Tiranë, 2002, fq. 43.

domosdoshme për Perandorinë, dhe faktikisht mbeten të vetmet statistika në të cilat numri i popullsisë shqiptare dihet totalisht, madje dhe sipërfaqja e banuar nga ata.

### **Regjistrimet e popullsisë gjatë viteve 1923-2011**

Në regjistrimin e popullsisë, të bërë në vitin 1923 nga shteti shqiptar, na rezulton se popullsia në total ishte 803.959 banorë, me një densitet prej 29 banorë/km<sup>2</sup>. Nga kjo popullsi, 530.604 ose 67% e saj ishin muslimanë, më së shumti dominohej nga muslimanët sunni dhe pakica bektashinj. Nga ky regjistrim rezultoi që 264.265 ose 23% e popullsisë së Shqipërisë ishin të krishterë, të ndarë përkatësisht në 168.215 ose 20% ortodoksë, dhe, 96.050 ose 13% e popullsisë katolikë.<sup>80</sup> Teki Selenica, kryeregjistruesi i vitit 1923, na jep disa të dhëna për vitin 1927, në të cilën thotë se: *Shqipëria kishte një sipërfaqe prej 27.538,20 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 833.618 banorë, përkatësisht të ndarë në 563.729 frymë muslimanë, 88.739 frymë katolikë dhe 181.051 frymë ortodoksë.*<sup>81</sup> *Ndryshimi nga viti 1923 ishte me një shtesë prej 29.891 banorë.*<sup>82</sup> Regjistrimet e popullsisë janë bërë dhe në vitin 1930, dhe sipas këtij Censusi, Shqipëria kishte tri fe kryesore, si dhe besimtarë të paktë të feve të tjera. Popullsia në total varionte nga 994.663 në disa të dhëna deri 1.003.097 banorë në disa të dhëna tjera. Për nga përkatësia fetare, popullsia ndahej në 69.4% muslimanë, 20% ortodoksë, dhe 10.5% katolikë.<sup>83</sup> Stavro Skëndo mbi përkatësinë fetare na thotë se: *Në 1937 muslimanët ishin 69.3% e popullsisë, sipas statistikave shqiptare të cilat e vlerësonin numrin e tyre në rreth 720.000.*<sup>84</sup>

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas një dokumenti italian të vitit 1942, numri i muslimanëve në Shqipëri ishte rreth 1.106.700

---

80 Teki Selenica, *Shqipëria më 1923*, Tiranë 1923, f. 8

81 Teki Selenica, *Shqipëria e ilustruar 1927*, f. 213-215, Gjithashtu dhe *Shqipëria 1927*; botuar në Tiranë, 1928.

82 Bërxolli, Arqile: *Minoritetet në Shqipëri*; Tiranë 2005, fq. 67

83 *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, TOENA, Tiranë, 2007, fq. 300.

84 S. Skëndo: "Albania" New York, 1956, fq. 287, dhe nga gazeta "Bashkimi", tetor 1945, cituar nga Dela Rooqa, fq. 19

banorë. Prej tyre 763.723 banorë ose 68.9% e ishin muslimanë, të cilët ndaheshin në 599.524 ose 78.5% prej tyre muslimanë sunni, dhe 164.199 ose 21.5% bektashinj. Në këtë vit, në vend kishte 229.080 ortodoksë ose 20.7% të popullsisë dhe 113.897 katolikë ose 10.3% e popullsisë.<sup>85</sup>

Sa i përket regjistrimit mbi përkatësinë fetare gjatë viteve 1945-1991, disa studiues duke menduar që komunizmi ishte shumë i egër me fetë në Shqipëri, thonë ose lënë të kuptohet se nuk kishte regjistrim mbi përkatësinë fetare të shqiptarëve, por faktikisht disa të tjerë, që e njohin më mirë këtë çështje, thonë se: Në regjistrimet e viteve 1969-1979 të dhënat mbi strukturën religjioze të popullsisë u hoqën edhe nga programi i regjistrimit, mbasi zyrtarisht shteti kishte ndaluar me ligj 'fenë',<sup>86</sup> kjo na lë të kuptojmë se faktikisht janë bërë regjistrimet mbi përkatësinë fetare në vitet e mëparshme. Nga përpunimi i materialit të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitin 1945 rezultoi se Shqipëria kishte një popullsi tërësore prej 1.122.044<sup>87</sup> banorësh. Pyetjes për përkatësinë fetare, 72.8% e popullsisë iu përgjigjën se ishin muslimanë, duke e bërë Shqipërinë të vetmin vend në Europë me shumicë dërrmuese muslimane; 17.1% e popullsisë u vetë deklaruan se i përkisnin fesë ortodokse, ndërsa 10.1% ishin katolike. Interesant është fakti se të gjithë shqiptarët pranonin se ishin fetarë.<sup>88</sup>

Një tjetër e dhënë thotë se: Në vitin 1945 në Shqipëri ka pasur 785.430 muslimanë në një popullsi prej 1.122.044 banorë, të cilët ndaheshin në dy grupe të mëdha: suni me një shumicë dërrmuese, dhe bektashi në pakicë.<sup>89</sup> Të dhëna të tjera të popullsisë mbi përkatësinë fetare gjatë viteve 1945-1967 për momentin në nuk i disponojmë. Normalisht që mbas ndalimit të fesë me ligj, nuk mund të mendohet që të jepej opsioni i regjistrimit të përkatësisë fetare në pyetësorë, prandaj deri në vitin 1991 nuk kemi të dhëna mbi

85 'La Documentation Francaise - Notes et Etudes documentaires, nr. 1843/2...; cituar nga Popoviç, A., *Islamizimi Ballkanik*, f. 53

86 Fiqiri Sheri, "Mbi regjistrimet e përgjithshme të popullsisë në Shqipëri" fq. 27, **Demografia** janar-qershor 1999, fq.19-30

87 A.Q.SH. F.890, D.333, Viti 1945

88 Jacques, Edwin: *Shqiptarët*, Kartë e Pendë, Tiranë, 2011, fq. 437.

89 Popoviç, Alexandre: *Islamizimi Ballkanik*,; Dituria, Tiranë, 2006, fq. 58

këtë çështje. Edhe gjatë dy dhjetëvjeçarëve të parë të pluralizmit, shteti shqiptar nuk mundi të realizojë një gjë të tillë, kështu që të vetmen të dhënë zyrtare që kemi gjatë këtyre 25 viteve pluralizëm, është vetëm Censusi i vitit 2011.

### **Regjistrimet e popullsisë mbi përkatësinë fetare në vitin 2011**

Bazuar në të dhënat e Censurit 2011, popullsia banuese e Republikës së Shqipërisë rezultoi të ishte 2 800 138 banorë. Rezerva dhe pakënaqësi në shumë drejtime solli ky pyetësor, duke filluar që nga pyetje të ndryshme të konsideruara nga masat e popullsisë si 'të kota', por që në vetvete ata janë matës të mirëqenies së popullsisë. Kishte kontestime që çdokush mund t'i vlerësojë si me vend, ku shpeshherë regjistruerit plotësonin formularët bazuar në njohuritë që ata kishin për individë apo familje të caktuara, ose nga të dhënat që u jepnin të afërm ose komshinj të tyre. Pa harruar kontestimin me vend të plotësimit të formularit me material të korrigjueshëm, si ishte lapsi etj. Sa i përket këtij vetëdeklarimi, Censurit 2011, mbi përkatësinë fetare të shqiptarëve, theksojmë që bashkë me përkatësinë etnike, kanë qenë dy pikat më të diskutuara madje dhe nga vetë ata që hartuan pyetësorin, për formën e ndërtimit dhe mënyrën e plotësimit të tij. Gjithashtu, këto dy pika kanë qenë pikat më të kontestuara nga grupe interesi të ndryshme, ku ky diskutim u kthye shpeshherë në çështje politike ndërkombëtare. Kjo për arsyen se nga minoriteti grek nuk pranohej kurrsesi kjo formë dhe se, sipas tyre, është një padrejtësi që u bëhet komunitarëve, duke e lidhur përkatësinë fetare me përkatësinë etnike. Pavarësisht të gjithave, ky Census na dha një rezultat mbi përkatësinë fetare dhe etnike të shqiptarëve mbas shumë dekadash, që mbas regjistrimit të fundit të bërë mbi përkatësinë fetare dhe etnike. Shqipëria është një nga vendet e rralla në botë, për mos me thënë i vetmi vend në botë që zyrtarisht u vetëshpall nga komunistët në vitin 1967 si shteti i parë ateist në botë. Në Kushtetutën e vendit u ndalua me ligj praktikimi i riteve fetare, pa marrë parasysh se për cilin nga përkatësitë fetare bëhej fjalë. Gjendja shkoi edhe më keq, kur popullit iu kërkua që askush të mos besonte, thënë ndryshe, regjimi komunist u mundua që

të futej jo vetëm në punët personale dhe veprat e njerëzve, por dhe në zemrat e tyre, që t'ia ndalonte besimin në Zot. Prej këtij pyetësi, na rezulton se ateistë janë vetëm 69.995 ose vetëm 2.5% e popullsisë së vendit. Duke pasur parasysh gjithë këto përpjekje për ndalimin e besimit në ekstremin e çdo lloj të menduari normal, ne mendojmë që rezultatet e këtij Censusi në këtë drejtim, ku ateistë janë vetëdeklaruar vetëm 2.5% e popullsisë, janë fakte treguese të pamohueshme që komunizmi dështoi në këtë pikë themelore të ideologjisë së tij, ashtu si dështoi në të gjitha drejtimet e shtetformimit të ideologjisë ateisto-komuniste.

Sa i përket besimtarëve, na rezulton që në këtë Census, 2.275.495 banorë, ose 81.27% e popullsisë, e kanë shprehur besimin e tyre, janë deklaruar si besimtarë të një besimi të caktuar. Sipas këtij regjistrimi, shqiptarët janë vetëdeklaruar: *muslimanë 1.587.608 banorë ose 56.7% e totalit të popullsisë; bektashinj 58.628 banorë, ose 2.09 % e popullsisë; katolikë 280.921 banorë, ose 10.03 % e popullsisë; ortodoksë 188.992 banorë, ose 6.75 % e popullsisë; ungjillorë 3797 banorë, ose 0.14 % e popullsisë; të krishterë të tjerë 1.919 banorë, ose 0.07 % e popullsisë; besimtarë të pacilësuar 153.630 banorë, ose 5.49% e popullsisë.*<sup>90</sup> Por ka dhe kategori të tjera të cilat, si shkak i kërkesave dhe protestave që vinin nga grupe të ndryshme interesi, apo nga shoqata të ndryshe, apo dhe nga parti politike, kanë zgjedhur opsionin e të mospërgjigjurit mbi përkatësinë fetare të tyre, apo që e kanë bërë të pavlefshme, pa përcaktuar këtë pikë të Censunit. *Kanë preferuar të mos i përgjigjen këtij pyetësi 386.024 banorë, ose 13.79% e popullsisë së vendit; gjithashtu dhe kategoria që nuk e kanë përcaktuar, apo e kanë bërë të pavlefshme këtë pyetje janë 68.022 banorë, ose 2.43 % e popullsisë.*

### Konkluzione

1. Gjatë periudhës së sundimit Osman në trojet shqiptare, regjistrimi i popullsisë ishte i vazhdueshëm dhe, për më tepër, pothuajse gjithçka niste mbi përkatësinë fetare, si të dhëna bazë për financat e Perandorisë Osmane.

90 Të dhënat janë marrë nga publikimet që ka bërë INSTAT (Instituti i Statistikave të Shqipërisë), pra janë të dhëna zyrtare.

2. Të dhënat e nxjerra nga Perandoria Osmane na orientojnë se, mbas pranimit të Islamit nga shumica e popullsisë shqiptare, që nga studiuesit thuhet se definitivisht ka qenë shekulli XVII, në të cilin raportet rezultonin rreth 70% muslimanë (sunnit dhe bektashi dhe sekte tjera), dhe 30% të krishterë, ku më së shumti ishin ortodoksë e më pak katolikë, normalisht dhe pakica fare e vogël hebrenjsh.
3. Shekulli XIX ishte shekulli që pothuajse e kristalizoi raportin e besimit fetar në trojet shqiptare, shifrat 70-20-10 për qind përkatësisht muslimanë, ortodoksë, katolikë, kishin qenë të vërteta. Këto të dhënat pothuajse janë të njëjta me një marsh gabimi të pranueshëm në +/- 5% në maksimumin më të madh.
4. Edhe pse ka pasur regjistrime mbi përkatësinë fetare mbas vitit 1945, çuditërisht studiuesit shqiptarë nuk kanë përmendur gjëkund asnjë fakt të tillë, pavarësisht se flitet për besimin e shqiptarëve, që bazuar në këto regjistrime janë pothuajse 100% besimtarë.
5. Mendojmë se statistikat duhet të jenë më specifike që të tregojnë realitetin e duhur, se a janë vërtetë besimtarë, dhe se cilit besim i përkasin, apo besimin e përlyejnë me besëtytni dhe kështu hamendësojmë se janë besimtarë etj., duke qartësuar çdokënd që i përgjigjet një pyetësori të jetë transparent!
6. Janë të pranueshme ankesat mbi saktësinë e gjithë këtyre regjistrimeve, por, kur çojmë në mendjen Censusin e vitit 2011 dhe parregullsitë që i kemi parë me sytë tanë, mund ta marrim me mend si kanë qenë censuset e tjera në vitet 1916, 1918, 1923, 1930, 1945, 1950, 1955, 1960, 1969, 1979, 1989, ku vështirësitë nga fillimi i shekullit ishin mjaft të mëdha, duke pasur parasysh dhe 'teknologjinë' e këtyre viteve dhe të tjera vështirësi.
7. Në ndryshim nga Censusi i 2011, personat që merreshin me këtë punë nga 1916 deri 1945, nuk kishin interesa që të bënin deformime në të dhëna për asnjë arsye, ajo që duhet thënë është se vërtet ata kanë pasur shumë vështirësi në kontaktin me njerëzit dhe se shpesh ata që ishin në lëvizje, nuk regjistroheshin.